

Kosova, një analizë juridike

Nën këtë titull në fund të vitit të kaluar, autori Christian Staub ka botuar librin "Kosova, një analizë Juridike". Ky libër përbën një përpjekje të autorit për të argumentuar se e drejta e Kosovës për t'u shkëputur mbështetet në kushtetutën e vitit 1974. Staub shkruan se Kombet e Bashkuara nuk kanë të drejtë të krijojnë apo shpërbëjnë shtete. Detyra e kësaj organizate ndërkombëtare është për t'i rregulluar marrëdhëniet mes shteteve ekzistuese.

Nga Faton Topalli

Viteve të fundit, numri i publikimeve për Kosovën, për shqiptarët, kulturën dhe historinë e tyre nga autorët e huaj është shtuar vazhdimisht. Christian Staub, edhe pse në librin tij merret sipërfaqësisht edhe me problemet historike, për aq sa është e nevojshme që lexuesit ta kuptojnë thelbin e problemit, ai ve fokusin në aspektet juridike të çështjes së Kosovës, duke vënë theks të veçantë në Kushtetutën e vitit 1974 të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Qasja me anën juridike të problemit është një kualitet i ri në trajtimin e problemit të dy milion shqiptarëve në Kosovë. Në këtë kuptim autori hedh dritë të re në mënyrën e trajtimit të problemit, duke sjellë për lexuesit e huaj fakte të reja për subjektivitetin e Kosovës.

Kushtetuta e vitit 1974

Kushtetuta e vitit 1974, shkruan Staub, sjell ndryshim të rëndësishme në të gjithë rregullimin shtetëror të vendit duke plotësuar kështu jo vetëm nevojat sunduesve, por edhe të popujve për t'i realizuar qëllimet nacionale, politike dhe për ta siguruar ekzistencën ekonomike. Ajo krijoi një rregull të ri të bashkëjetesës mes popujve i cili do të mbështetej mbi bazën e barazisë dhe kooperimit mes tyre.

Christian Staub përpikët të argumentojë që Kushtetuta e vitit 1974 përbëhet nga dispozitat të cilat kanë karakter deklarativ propagandistik dhe nga dispozitat që kanë karakter normativ. Në radhën e dispozitave deklarative që kanë karakter propagandistik hyjnë emërimet si psh., Krahuja Autonome e Kosovës. Dispozitat me karakter

Christian Staub

Ka lindur me 16. shtatorë të vitit 1962 afër Cyrihut. Fëmijërinë dhe rinin e ka kaluar në Zvicër, Itali, Spanjë dhe Turqi. Prej vitit 1980 deri në vitin 1984 ka qenë në shërbim të Shtetit Zvicerian. Ka jetuar edhe në Angli dhe SHBA duke punuar në fusha të ndryshme të industrisë financiare. Staub ka studiuar në Friburg Shkencat Juridike. Një pjesë të studimeve i ka ndjekur në Fakultetin e Shkencave Juridike në Universitetin Le Havre të Francës. Staub është autorë i librave: Kush jemi ne? Identiteti i Evropës Vizioni i humbësve. Një raport për gjendjen Rruga politike deri tek Kushtetuta e një vendi Kushtetuta për Bashkësinë Evropiane – Propozime dhe raporte.

Libri "Kosova, një analizë juridike" ISBN: 978-3-8370-2622-1, i botuar nga Books on Demand, mund të porositet në çdo librari në Zvicër dhe Gjermani dhe kushton 19.80 Euro. Libri është publikuar në gjuhën gjermane.



propagandistik, sipas autorit nuk kanë peshë në përcaktimin e subjektivitetit të një njësie. Ky subjektivitet, të drejtat dhe obligimet, përcaktohen me dispozitat që kanë karakter të kualitetit normativ. Në kuptimin e dispozitave normative, Christian Staub përpikët të argumentojë që Kosova, sipas kushtetutës së vitit 1974 ishte e barabartë me 7 subjektet tjera të cilat përbënin Federatën.

Poliza Juridike e Kosovës

Poliza e Kosovës, sipas Kushtetutës së Federatës, si një nga pjesët e sajë është shumë pak e njohur, shkruan Autori. Ai vë në dukje se Kosova, në të gjitha pjesët e Kushtetutës që kishin karakter të kualitetit normativ ishte e barabartë në të drejta dhe obligime me pjesët tjera të Federatës. Ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës e cila mbështetej mbi Kushtetutën e Federatës nuk mund të bëhej pa pëlqimin e Kosovës, madje pa pëlqimin e Kosovës nuk mund të

ndryshoheshin as kufijtë e jashtëm të Federatës.

Tezën që e mbron Christian Staub e ka mbrojtur edhe gazetari i njohur zviceran Viktor Meier i gazetës "Frankfurter Allgemeiner Zeitung". Ndryshimi qëndron në faktin që Staub bënë një thellim në këtë çështje duke bërë një diferencim të problemit dhe duke u thirrur në dispozitat e veçanta për të argumentuar tezat e tij.

A është ndarja e Kosovës prej Serbisë e ligjshme?

Libri "Kosova, një analizë juridike" fiton një rëndësi të veçantë pas kërkesës së Serbisë drejtuar Kombeve të Bashkuara për të shqyrtuar çështjen se a është ndarja e Kosovës nga Serbia konformë të së drejtës ndërkombëtare? Siç dihet me këtë çështje do të merret Gjyqi Ndërkombëtarë në Hagë. Christian Staub përpikët të argumentojë se e drejta e Kosovës për t'u shkëputur nga Federata bazohet në

Kushtetutën e vitit 1974. Kjo e drejtë iu njoh të gjithë popujve të Jugosllavisë. Staub thekson se Kosova përmes referendumit shprehu vullnetin e saj të lirë dhe realizoi edhe kushtet formale për shkëputje.

OKB s'ka të drejtë të krijoj apo të shuaj shtete

Interesant për lexuesin e huaj, por edhe atë shqiptar në librin e janë interpretimet që bënë Staub rreth detyrave dhe rolit që kanë Kombet e Bashkuara. Ai thekson se Kombet e Bashkuara janë një organizatë ndërkombëtare e cila merret me rregullimin e raporteve mes shteteve. OKB, sipas Staub nuk ka të drejtë të krijojë as të shuaj shtete.

Ai shkon madje edhe më larg duke akuzuar Bashkësinë Evropiane për ndërhyrjen e një Organizate ndërkombëtare si OKB në punët e brendshme të Evropës siç është problemi me Kosovën.